



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 175 dt.24.10.1996

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.24.10.1996, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur në mbledhjen e dt.10.10.1996, të Drejtorisë së Shërbimeve Publike “Për privatizimin e godinës në Rr.”Avni Rustemi”, Nr.58 “

**VENDOSI**

1. Të anulohet pika.7 e Vendimit Nr.153, dt.10.10.1996, sepse në bazë të vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave Nr.339, dt.19.04.1994, kjo banesë i është kthyer pronarëve Ali Mulleti, e cila është hipotekuar në regjistrin hipotekor Nr.1540, dt.04.05.1994. Në këto kushte, objekti i mësipërm nuk është subjekt i Dekretit të Presidentit të Republikës Nr.14, dt.04.04.1996 “Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara”.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**